



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

---

Numri i lëndës: 2023:222606  
Datë: 13.05.2024  
Numri i dokumentit: 05676977

2023:222607

Gjykata Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Armend Ahmeti, në çështjen juridike kontestimore të paditësit R.Z. nga fshati ..., Komuna Ferizaj, me numër personal ..., të cilin e përfaqëson i autorizuari av. Arben Isufi nga Ferizaj kundër të paditurit A.Sh.A. nga Gjilani, rr. ... pn (afër A.P. në dalje të Gjilanit), me objekt kontesti vërtetim pronësie, vlera e kontestit 500,00€, me datë 13.05.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

I. Procedura në këtë çështje juridike kontestimore ndërpritet për shkak të vdekjes së të paditurit.

II. Procedura e ndërprerë do të vazhdojë kur trashëgimtarët e të ndjerit-të paditurit e marrin përsipër procedurën, apo kur të njëjtit i thërret gjykata që ta bëjnë këtë me propozimin e palës kundërshtare.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij av. Arben Isufi nga Ferizaj pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi me datë 19.10.2023 kundër të paditurit, me objektin e kontestit vërtetim pronësie, vlera e kontestit 500,00€.

Gjykata sipas detyrës zyrtare përmes adresës elektronike iu është drejtuar Zyrës së Gjendjes Civile-Ofiqarisë në Ferizaj me kërkesë për verifikim të adresës të paditurit, pasi që gjatë tentimit të dorëzimit të aktvendimit për përgjigje në padi, padisë dhe provave sipas fletëkthesës së datës 03.01.2024 ka rezultuar që pala është i panjohur dhe adresa jo e saktë.

Zyra e Gjendjes Civile-Ofiqaria në Ferizaj përmes adresës elektronike, e ka njoftur gjykatën se i padituri A. (Sh.) F. ka vdekur dhe si provë ia ka bashkangjitur certifikatën e vdekjes së tij të

datës 24.04.2024, me nr. rendor 1..., nr. të referencës 4..., përmes së cilës vërtetohet se i njëjti ka vdekur me datën ... në Gjilan.

Andaj, bazuar në certifikatën e vdekjes dhe vetë faktit se tani i padituri është i vdekur, konform dispozitave ligjore nga neni 277 pika a) të LPK-së, gjykata ka ndërprerë procedurën në këtë çështje juridike kontestimore. Ndërsa ka vendosur se procedura e ndërprerë do të vazhdojë kur trashëgimtarët e të ndjerit-të paditurit e marrin përsipër procedurën, apo kur të njëjtit i thërret gjykata që ta bëjnë këtë me propozimin e palës kundërshtare.

Nga arsyet e lartcekura e konform nenit 387, pika e) e LPK lidhur me nenin 142 të LPK, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata Themelore në Ferizaj  
2023:222607, me datë 13.05.2024

Gjyqtari,  
Armend Ahmeti

Udhëzimi mbi mjetin juridik: Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, në Gjykatën e Apelit të Kosovës, e nëpërmjet kësaj gjykate.